

Në bazë të dispozitave të nenit 41 dhe 198 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 9/24 maj 2018, Prishtinë), në bazë të vendimit të datës 11.05.2023, Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike "Termokos" Sh.A, në Prishtinë, me numër të biznesit: **810514829**, miraton:

## STATUTIN E NDËRMARRJES PUBLIKE "TERMOKOS" SH.A, NË PRISHTINË

### Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Me këtë statut përcaktohen parimet themelore për statusin, organizimin dhe afarizmin e Ndërmarrjes Publike "Termokos" Sh.A, në Prishtinë (në tekstin e mëtejme - NP "Termokos" Sh. A, në Prishtinë).
- 1.2 NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë, ka statusin e subjektit juridik e cila mund të padis dhe të paditet, të posedojë e të menaxhojë pasurinë dhe i përcakton kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të saj, të lidhë kontrata, të punësojë dhe të largojë stafin dhe të angazhohet në aktivitete të cilat janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saja nëse nuk është rregulluar ndryshe me ligj.

### Neni 2 Statuti

- 2.1 NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë nxjerr Statutin si akt themelor të saj.
- 2.2 Statuti i NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë, miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
- 2.3 NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë, themelohet vetëm pas regjistrimit të këtij Statuti në Zyrën e Regjistrimit të Bizneseve. Ky Statut, i miratuar, ndryshuar apo plotësuar ka efekt juridik vetëm pas miratimit nga Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe pas dorëzimit në Zyrën e Regjistrimit të Biznesit në përputhje me ligjin.
- 2.4 Në rast konflikti, Statuti i NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë, mbizotëron mbi rregulloret dhe aktet tjera të brendshme.

### Neni 3 Themeluesit

- 3.1 Komuna e Prishtinës është pronare e vetme e NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë, me kapital publik.
- 3.2 NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë, është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare".

3.3NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë është trashëgimtare e Ngrohtores së Qytetit "Termokos" në Prishtinë.

#### **Neni 4 Emërtimi**

4.1 Emërtimi zyrtar i Ndërmarrjes është:

**Ndërmarrja Publike "Termokos" Sh.A, në Prishtinë**

4.2 Emërtimi i shkurtër i Ndërmarrjes është:

**NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë**

4.3 Meqenëse NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë është shoqëri aksionare, në kuptim të këtij Statuti, në tekstin e mëtejme termi i përdorur "**Ndërmarrja**" nënkupton Ndërmarrjen Publike "Termokos" Sh.A, Prishtinë.

#### **Neni 5 Selia**

Selia e NP "Termokos" Sh.A, është rruga "28 Nëntori", nr. 181, Prishtinë, 10 000, Republika e Kosovës.

#### **Neni 6 Vula dhe shenja**

6.1 NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë, ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore (protokol).

6.2 Vula e NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë duhet të ketë elementet e emërimit zyrtar:  
**Ndërmarrja Publike "Termokos" Sh.A, në Prishtinë** (në gjuhët zyrtare).

6.3 NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë ka shenjën e vet. Shenja ka pamjen: Emblemën e dizajnuar. Vendimin për formën e emblemës e miraton Bordi i Drejtorëve.

#### **Neni 7 Kohëzgjatja**

7.1 Kohëzgjatja e Ndërmarrjes është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe nga organet drejtuese të saj.

7.2 Nëse kohëzgjatja e Ndërmarrjes ndryshohet, atëherë duhet njoftuar menjëherë Zyra e Regjistrimit të Bizneseve dhe kjo të publikohet nga ana e kësaj zyreje në bazën e të dhënave të saj.

#### **Neni 8 Veprimtaria**

8.1 Veprimtaria e NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë është: **Prodhimi, Distribuimi dhe Furnizimi** i konsumatorëve me energji termike.

8.2 Kryerja e punëve dhe ushtrimi i veprimtarive tjera për të cilat kanë të bëjnë me misionin bazë dhe për të cilat licençohet.

#### **Neni 9**

### **Përgjegjësitë**

9.1 NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë, si trashëgimtare e Ngrohtores së Qytetit "Termokos" në Prishtinë është përgjegjëse për asetet dhe pasurinë. Ajo trashëgon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që vijnë si rezultat i këtij transformimi.

9.2 Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionar në Ndërmarrje.

9.3 Nëse janë ndërmarrë veprime në emër të ish ndërmarrjes, para regjistrimit duke përfshirë por pa u kufizuar në hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, pasi Ndërmarrja të jetë regjistruar, ajo merr përsipër përgjegjësitë për këto detyrime dhe këto raste, Ndërmarrja është e vetmja palë përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet.

### **Neni 10 Kapitali**

10.1 Kapitali themeltar i Ndërmarrjes është 25.000.00 (njëzetepesë mijë) € dhe është i ndarë në 25,000.00 (njëzetepesë mijë aksione) aksione, me vlerë nominale 1.00 € (një) për 1 (një) aksion.

10.2 Aksionari i vetëm i NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë është Komuna e Prishtinës.

10.3 Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas përcaktimit me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, ku përfshihet shuma, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve, etj.

### **Neni 11 Aksionet**

11.1 NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë do të ketë listën e aksioneve.

11.2 Aksionet janë të formës nominale, të thjeshta ose të privileguara, të çertifikuara ose të pa çertifikuara, te letrave me vlerë, si dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.

11.3 Vlera e aksionit të thjeshtë të NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë është: 100 (njëqind) €.

11.4 Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e Ndërmarrjes apo ndërmjetësve financiarë.

11.5 Aksionet e NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë zotërohen në masën 100% nga Komuna e Prishtinës.

**Neni 12****Shpërndarja e dividendeve**

12.1 Vendimi për autorizimin dhe pagimin e dividendeve mund të bëhet vetëm nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

12.2 Bordi i Drejtorëve NP "Termokos" Sh.A, Prishtinë NP "Termokos" Sh.A, në Prishtinë, mundet të deklaroj dhe paguaj dividendet vetëm nëse është autorizuar me vendim të veçantë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

**Neni 13****Ushtrimi i të drejtave të Aksionarit**

13.1 Komuna e Prishtinës si aksionar i vetëm i Ndërmarrjes, të drejtat e saj të aksionarit i ushtron nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.

13.2 Komisioni Komunal i Aksionarëve siguron informacione për veprimtarinë e Ndërmarrjes në bazë të raporteve periodike (tre-mujore dhe vjetore) të siguruar nga Bordi i Drejtorëve. E në raste të veçanta Komisioni Komunal i Aksionarëve mund të kërkoj raporte ose informata shtesë.

13.3 Është obligim i Komisionit Komunal të Aksionarëve që së paku një here në vit të organizoj një takim të përbashkët me Bordin e Drejtorëve.

13.4 Në rast se Performanca e Ndërmarrjes devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e biznesit të miratuar nga bordi i drejtorëve për vitin përkatës financiar; nëse vlera e asetëve të NP

zvogëlohet; dhe/ose nëse bie niveli i kënaqshmërisë së konsumatorëve lidhur me cilësinë e shërbimeve, atëherë Komisioni Komunal i Aksionarëve do të marrë parasyshë masa të nevojshme korigjuese.

13.5 Nëse Ndërmarrja dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, Komisioni Komunal i Aksionarëve është i detyruar që të marrë parasyshë shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të Bordit, përveç nëse Komisioni Komunal i Aksionarëve konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportoj Kuvendit Komunal të Prishtinës për çdo vendim të marrë në bazë të këtij neni dhe mbi arsyet e marrjes së tij.

13.6 Komunikimi ndërmjet Komisionit Komunal të Aksionarëve dhe Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes bëhet nëpërmes Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.

13.7 Detyrimi për mbikëqyrje të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve nga Komisioni Komunal i Aksionarëve nuk nënkupton ndërhyrje në veprimtarinë ose pavarësinë e Bordit.

13.8 Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të tij. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i sigurojë të dhëna të mjaftueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes në interes të Komunës.

13.9 Komisioni Komunal i Aksionarëve realizon edhe detyra tjera të bazuara në legjislacionin në fuqi.

#### Neni 14

#### Bordi i Drejtorëve

14.1 Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes përbëhet nga 5 (pesë) drejtorë.

14.2 4 (Katër) drejtorë emërohen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin dhe secili ka mandat prej 3 (tri) viteve. Komisioni Komunal i Aksionarëve emëron 4 (katër) drejtorë të përkohshëm, ndërsa drejtori tjetër është KE i Ndërmarrjes i cili emërohet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së.

Drejtorët e Bordit të janë:

-**Visar Vokrri** me nr. personal: [REDACTED] i emëruar me vendimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve nr.685 të datës 13.03.2023 dhe i zgjedhur Kryesues i Bordit të Drejtorëve me vendimin nr. 712 dt. 16.03.2023 (Kryesues i Bordit të Drejtorëve).

-**Shukrije Morina** me nr. personal: [REDACTED] e emëruar me vendimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve nr.685 të datës 13.03.2023 (Anëtare e Bordit të Drejtorëve).

-**Vesa Kelmendi** me nr. personal: [REDACTED] e emëruar me vendimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve nr.685 të datës 13.03.2023 (Anëtare e Bordit të Drejtorëve).

-**Mentor Maliqi** me nr. personal: [REDACTED] i emëruar me vendimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve nr. 685 të datës 13.03.2023 (Antar i Bordit të Drejtorëve).

14.3 Bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes, menjëherë pas emërimit, do të zgjedhë njërin nga anëtarët e tij për të shërbyer si kryesues. Përveç anëtarit i cili shërben si KE, asnjë anëtar i Bordit të Drejtorëve nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. KE nuk mund të shërbejë si kryesues ose ushtrues detyre i kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.

14.4 Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së.

14.5 Nëse përforma e Ndërmarrjes devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit për vitin përkatës financiar, Bordi i Drejtorëve do të kërkojë një raport nga KE që t'i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe do të marrë të gjitha masat e duhura korrigjuese.

14.6 Nëse Ndërmarrja dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve është i detyruar të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e KE-së. Ky veprim mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës, përveç nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se përforma e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Bordi i Drejtorëve do t'ia raportojnë Komisionit Komunal të Aksionarëve çdo vendim të marrë në bazë të këtij paragrafi.

14.7 Bordi i Drejtorëve në bazë vjetore do të bëjë një vlerësim sistematik të performancës së vet. Kryesuesi është kryesisht përgjegjës për të siguruar kryerjen e rregullt dhe me kohë të vlerësimit. Vlerësimi do të analizojë performancën e përgjithshme të Bordit si dhe efektshmërinë dhe kontributin e anëtarëve individual të Bordit. Vlerësimi po ashtu, ndër tjera, do të vlerësojë llojllojshmërinë e aftësive dhe përvojës si dhe kualifikimet tjera profesionale me qëllim të vlerësimit të efektshmërisë së Bordit në tërësi dhe komisioneve të tij. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Bordi mund të kërkojë këshilla nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur si dhe nga përfaqësuesit e Aksionarit(ëve).

14.8 Bordi duhet të sigurojë që rezultatet e vlerësimit të realizuar sipas paragrafit paraprak të përmblihen në një raport me shkrim i cili i dërgohet anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve më së largu deri me 30 maj të vitit përkatës.

14.9 Në raste të veçanta, sipas vlerësimit të Bordit, mund të ftohen në takim edhe zyrtarët tjerë të Ndërmarrjes.

14.10 Kompensimi i Drejtorëve do të realizohet në bazë të nenit 20 të Ligji nr. 03/L-087 (Për Ndërmarrjet Publike) dhe nenit 12 të ligjit 04/L-111.

14.11 Bordi i Drejtorëve duhet të nxjerrë organogramin dhe të gjitha rregulloret e Ndërmarrjes si edhe rregulloren e vet të punës.

## Neni 15

### Komisioni i Auditimit

15.1 Komisioni i Auditimit do të përbëhet nga 3 (tre) drejtorë të zgjedhur. Komisioni i Auditimit caktohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

15.2 Komisioni i Auditimit do të vërtetojë nëse veprimtaria dhe punët e Ndërmarrjes janë duke u ushtruar në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme, dhe ekskluzivisht në interes të Ndërmarrjes.

**Neni 16****Funksionet dhe kompetencat e Komisionit të Auditimit**

16.1 Kompetencat e Komisionit të Auditimit janë ekskluzive.

16.2 Komisioni i Auditimit, me përgjegjësi kolektive:

- a) do t'i përmbahet Statutit dhe Rregulloreve të Ndërmarrjes;
- b) do t'i shqyrtojë planet afat-gjate strategjike, të investimeve dhe financiare të Ndërmarrjes, së bashku me çfarëdo ndryshim plotësimi të tyre, si dhe planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor para miratimit të tyre nga Bordi i Drejtorëve në tërësi, si dhe t'i sigurojë këtij të fundit të gjitha vërejtjet ose kundërshtimet të cilat i konsideron të nevojshme;
- c) para miratimit nga Bordi i Drejtorëve (i) do të shqyrtojë pasqyrën vjetore të bilancit si dhe deklaratën e fitimeve dhe humbjeve të Ndërmarrjes si dhe cilatdo deklarata tjera financiare që kërkohen me ligj, si dhe raportin vjetor mbi menaxhimin, politikën afariste dhe financiare dhe gjendjen industriale të Ndërmarrjes; dhe (ii) do t'i dorëzojë Bordit të Drejtorëve një raport mbi përshtatshmërinë, saktësinë, vërtetësinë dhe përputhjen me ligjin të këtyre dokumenteve;
- ç) rregullisht do të shqyrtojë gjendjen financiare të Ndërmarrjes dhe kushtet e saj të planifikuara financiare, si dhe do t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- d) rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- dh) rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i Ndërmarrjes, duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- e) rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga Ndërmarrja të të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Bordit të Drejtorëve çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- ë) do të emërojë, shkarkojë dhe zëvendësojë Zyrтарin e Auditimit të Brendshëm si dhe të përcaktojë kompensimin dhe përfitimet e tij/saj, përcaktim ky që duhet të pasqyrohet në deklaratën e politikës së kompensimit të kërkuar sipas Ligjit Nr. 03/L-087.
- f) do të sigurojë që zyra e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të pajiset me personel në mënyrë të rregullt dhe adekuate, dhe rregullisht do të verifikojë

përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kësaj zyre si dhe do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm dhe zyrën e auditimit të brendshëm;

g) do t'i shqyrtojë të gjitha Transaksionet me Palët e Ndërlidhura, t'i autorizojë ato të cilat janë të arsyeshme dhe kushtet e të cilave janë të drejta për Ndërmarrjen ose, nëse aplikohen kufizimet e përcaktuara me ligj, ta këshillojë Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi arsyeshmërinë dhe drejtësinë e tyre;

gj) do t'i mbajë sekret në mënyrë rigoroze të gjitha raportet jo-anonime të cilat paraqiten nga një punonjës dhe që kanë të bëjnë me pohime për keq bërje nga një drejtor, zyrtar ose punonjës tjetër i Ndërmarrjes; do të mbrojë identitetin e cilitdo person i cili mund t'i nënshtrohet ndëshkimit si rezultat i paraqitjes së një raporti të kësaj natyre; dhe gjatë mbrojtjes së çfarëdo informate përkatëse- sekrete, shkurtimisht ta informojë punonjësin i cili ka paraqitur raportin e lartë përmendur mbi përfundimet e hetimit i cili është iniciuar si rezultat i paraqitjes së raportit nga ana e tij; dhe

l) kur është e nevojshme, do t'i propozojë Bordit të Drejtorëve masa të cilat mund të jenë të nevojshme për zbatimin e detyrave fiduciare të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm.

## Neni 17

### Kompetencat e Komisionit të Auditimit

17.1 Komisioni i Auditimit është i autorizuar që:

a) t'a udhëzojë Zyrtarin për Auditim të Brendshëm që të kryejë detyra dhe veprime të cilat janë në kuadër të kompetencave të Komisionit të Auditimit;

b) të marrë çfarëdo informate lidhur me veprimtarinë dhe punët e Ndërmarrjes nga cilido zyrtar ose punonjës i Ndërmarrjes;

c) të kërkojë këshilla nga profesionistë të pavarur, të prokuruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, kurdo që një çështje me arsye kërkon pavarësinë e këtyre këshilltarëve nga zyrtarët ose menaxherët e lartë të Ndërmarrjes;

ç) të kërkojë mbajtjen e një mbledhje të Bordit të Drejtorëve, dhe të tregojë agjendën e kësaj mbledhje;

d) t'ua parashtrojë çfarëdo çështje që ka të bëjë me NP-në gjykatave ose organeve kompetente për zbatimin e ligjit;

## Neni 18

### Rregullorja e punës

18.1 Komisioni i Auditimit nxjerr rregulloren e vet të punës bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Stautit të Ndërmarrjes.



**Neni 19****Zyrtarët e Ndërmarrjes**

19.1 Zyrtarët e Ndërmarrjes emërohen nga Bordi i Drejtorëve. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarin për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarin e arsyes.

19.2 NP Termokos ka këta 4 (katër) zyrtarë në vijim: (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm. Nëse është e nevojshme për shkak të madhësisë dhe/ose llojllojshmërisë së veprimtarive, Ndërmarrja mundet, nëse vendoset nga Bordi i Drejtorëve dhe përcaktohet në Rregullore që po ashtu të ketë një ose dy poste të Zëvendës të Kryeshefit.

19.3 Zgjedhja dhe emërimi i Zyrtarëve është e rregulluar me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike.

**Neni 20****Kryeshefi Ekzekutiv (KE)**

20.1 **Kryeshef Ekzekutiv** në momentin e regjistrimit të këtij Statuti është: **Fisnik Osmani** me nr. personal: [REDACTED] i emëruar me vendimin e Bordit të Drejtorëve nr.1268 të datës 20.09.2022 (Kryeshef Ekzekutiv).

20.2 Detyrat dhe kompetencat e Kryshefit Ekzekutiv:

- a) merr pjesë në takimet e Bordit nëse pjesmarrja e tij nuk paraqet konflikt interesi apo bie ndesh me problematikën që trajton Bordi (sipas vendimit të Bordit);
- b) është përgjegjësi kryesor për mbarvajtjen e punëve, respektimin realizimin e planeve, respektimin e orarit dhe disciplines, marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe të gjitha elementeve tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e suksesshme të Ndërmarrjes;
- c) përfaqëson Ndërmarrjen brenda dhe jashtë vendit;
- ç) në realizimin e misionit duhet bashkëpunuar me prioritet të veçantë me Zyrtarët e Ndërmarrjes.
- d) nënshkruan të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Ndërmarrjes;
- dh) ka autoritet të punësojë apo të largojë nga puna zyrtarët dhe stafin e Ndërmarrjes, duke siguruar konkurrencë, transparencë dhe zbatueshmëri të ligjit.
- e) biznesi, detyrat dhe organizimi i Ndërmarrjes kryhen nën mbikëqyrje dhe përgjegjësi të KE-së, në pajtim me dispozitat pozitive në Kosovë, të Statutit dhe akteve tjera juridike të Ndërmarrjes.

- e) këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së Ndërmarrjes si dhe planet e saja strategjike afatgjata;
- f) është përgjegjës për përgatitjen, përmbajtjen dhe mbrojtjen e raporteve periodike në Komisionin e Auditimit dhe në Bord.
- g) kryen edhe detyra tjera të parapara me ligj, Statut dhe sipas kërkesës së organeve mbikëqyrëse.

## Neni 21

### Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH)

21.1 Detyra dhe Kompetencat e Zyrtares Kryesore Financiare dhe të Thesarit (ZKFTH):

- a) është zyrtari më i lartë financiar dhe i thesarit;
- b) nën drejtimin e mbikëqyrjen e KE, menaxhon çështjet financiare të Ndërmarrjes;
- c) në aspektin financiar është bashkëpunatori më i afërt i KE-së;
- ç) bashkërendon veprimtarinë e Departamentit Financiar;
- d) është përgjegjës kryesor për përgatitjen e planeve dhe raporteve financiare;
- dh) merr pjesë në takimet e Bordit dhe të Komisionit të Auditimit (sipas kërkesës);
- e) kryen të gjitha detyrat tjera financiare në bazë të ligjit, Statutit dhe vendimeve.

## Neni 22

### Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës

22.1 Detyrat dhe Kompetencat e Këshilltarit të Përgjithshëm/Sekretarit të Korporatës:

- a) është zyrtari më i lartë ligjor;
- b) është përgjegjës kryesor në përpilimin e legjislacionit sekondar;
- c) përcjellë ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me Ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë;
- ç) bashkëpunon ngushtë me kryesuesin e Bordit në përgatitjen dhe mbarvajtjen e takimeve të Bordit;
- d) përgatitë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për takimet e Bordit, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve tjera që i formon Bordi;
- dh) është përgjegjës për gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së Bordit;
- e) në aspektin juridik bashkëpunatori më i afërt i KE-së;
- ë) bashkërendon veprimtarinë e Departamentit Ligjor;
- f) është përgjegjës kryesor për përgatitjen e raporteve periodike në mënyrë ekskluzive mbi pjesën e sundimit të rendit dhe ligjin;

g) kryen të gjitha detyrat tjera që kanë të bëjnë me respektimin e rendit dhe ligjit dhe kërkesave të organeve mbikëqyrëse.

### **Neni 23**

#### **Auditori i Brendshëm i Ndërmarrjes**

24.1 Detyrat dhe kompetencat e Auditorit të Brendshëm:

- a) kryen veprimtarinë e tij/saj nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij;
- b) udhëheqë dhe menaxhon organizimin e brendshëm të Zyrës së auditimit, duke zgjedhur stafin e tij/saj;
- c) udhëheqë dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm;
- ç) përgatitë planin vjetor të auditimit të brendshëm;
- ç) përmbushë çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

### **Neni 24**

#### **Detyrat e Besuara**

24.1 Çdo Drejtor dhe Zyrtar do të ketë detyra të lëna në mirëbesim për Ndërmarrjen, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do të përfshijnë detyrat që të:

- a) veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për interesin e përgjithshëm dhe përfitime objektive të Ndërmarrjes, gjithmonë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin;
- b) ushtrojnë fuqinë që i është dhënë atij/asaj ekskluzivisht në përputhje me interesat më të mira të përgjithshme dhe objektive të Ndërmarrjes;
- c) ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlíkueshmërinë e tyre;
- ç) shmangë dhe shpallorë konfliktet potenciale në mes të interesave personale (direkte apo indirekte) dhe të interesave të Ndërmarrjes.

### **Neni 25**

#### **Komisionet e Bordit**

25.1 Me qëllim të realizimit të detyrave të përcaktuara me ligj, Bordi i Drejtorëve mund të formoj komisione të veçanta.

25.2 Mënyra e veprimit të këtyre komisioneve përcaktohet me Rregulloren e Brendshme të Punës së Bordit.

25.3 Këto komisione kanë karakter *ad hoc* (të përkohshëm) për realizimin e detyrave të veçanta.

25.4 Këto komisione mund të përfshijnë edhe anëtarët e Bordit të drejtorëve dhe punëtorët e Ndërmarrjes si dhe persona jashtë kompanisë, sipas vlerësimit të Bordit.

**Neni 26****Auditimi i Jashtëm**

26.1 Ndërmarrja do t'i nënshtrohet Auditimit të jashtëm vjetor dhe objektiv nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar.

26.2 Auditori duhet t'i sigurojë Bordit dhe Aksionarëve një vlerësim të certifikuar profesional mbi faktin nëse deklaratat financiare të Ndërmarrjes e paraqesin në mënyrë të drejtë, në përputhje me rregullat dhe parimet e kontabilitetit të përmendura në ligjin në fuqi, gjendjen financiare dhe performancën e Ndërmarrjes në të gjitha aspektet materiale. Auditori po ashtu duhet të sigurojë një opinionin lidhur me mënyrën në të cilën janë përgatitur dhe prezantuar deklaratat financiare të Ndërmarrjes. Auditori ka detyrime fiduciare ndaj Ndërmarrjes dhe Aksionarit(ëve) për të ushtruar kujdes të shtuar profesional gjatë kryerjes së autorizimit të jashtëm dhe përgatitjes së vlerësimit dhe opinionit të kërkuar sipas këtij neni.

26.3 Raporti i Auditorit duhet të publikohet.

26.4 Është obligim i menaxhmentit të Ndërmarrjes që t'i evitojë të gjitha mangësitë e konstatuara në raport.

**Neni 27****Rregulloret**

27.1 Miratimi, ndryshimi dhe plotësimi si dhe shfuqizimi i rregulloreve është kompetencë ekskluzive e Bordit të Drejtorëve.

27.2 Një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të Ndërmarrjes do të publikohet dhe mbahet në faqen elektronike zyrtare të Ndërmarrjes.

27.3 Dispozitat e rregulloreve të Ndërmarrjes duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Përveç kësaj, rregulloret gjithashtu duhet të përmbajnë dispozita të cilat përshkruajnë në mënyrë të hollësishme:

- a) titujt, detyrat dhe kompetencat e secilit Zyrtar të Ndërmarrjes;
- b) procedurat e Ndërmarrjes për monitorimin dhe kontrollimin e konfliktit të interesave; dhe
- c) të gjitha çështjet që lidhen me misionin specifik të Ndërmarrjes.

**Neni 28****Faqja elektronike e Ndërmarrjes**

28.1 Me qëllim të realizimit të parimit të transparencës, Ndërmarrja krijon, mirëmbanë dhe azhurnon faqen e rregullt elektronike.

28.2 Është obligim i Ndërmarrjes që të caktoj zyrtarët e IT-së që në mënyrë permanente të menaxhojnë faqen elektronike.

28.3 Në web-faqe duhet të publikohen të gjitha informatat dhe dokumentet (legjislacioni sekondar, planet dhe raportet etj.,) publikimi i të cilave nuk cënon konfidencialitetin e veprimitarisë së Ndërmarrjes.

28.4 Është obligim i zyrtarit të IT-së që të raportoj në baza periodike për aktivitetet/gjendjen e web-faqes.

**Neni 29****Dispozitat Përfundimtare**

29.1 Ky Statut hyn në fuqi ditën e publikimit nga ARBK.

29.2 Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Statut vlejné në mënyrë të drejtpërdrejtë normat e legjislacionit në fuqi.

29.3 Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti detyrohet Bordi dhe menaxhmenti i Ndërmarrjes që të ndërmer veprimet e nevojshme për jetësimin e normave të këtij Statuti.

Prishtinë, më 11 / 05 / 2023

**KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE****ALBAN ZOGAJ – Anëtar KKA****MILAZIM VITIJA – Anëtar KKA****JETA RAFUNA-HASANI – Anëtare KKA**